



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

N^o 8372 Prot.

Tiranë, më 08.12.2022

SJELLJE NË VËMENDJE

Drejtuar: Autoriteteve kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në ushtrim të kompetencave të saj, sipas parashikimeve të nenit 23, gërma "ç" të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", në kuadër të dhënies së këshillave dhe asistencës, marrë shkas edhe nga problematikat e adresuara pranë saj, sjell në vëmendje si më poshtë vijon:

Në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, që kanë si objekt shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve të zbatimit në ndërtim, janë evidentuar raste kur, autoritetet kontraktore nuk japin informacion mbi grupin tarifor, ose japin disa grupe tarifore respektive, ku bën pjesë objekti i prokurimit, për të cilin kërkohet shërbimi i mbikëqyrjes, duke krijuar kështu konfuzion tek operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertës së tyre.

Me qëllim respektimin e kuadrit ligjor në fuqi të prokurimit publik, në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të shërbimit të mbikëqyrjes dhe/ose kolaudit, sjellim në vëmendje të, autoriteteve kontraktore që të respektojnë **Rekomandimin e APP Nr. 6559 Prot., datë 27.06.2018.**

Në këto procedura, autoritetet kontraktore duhet të japin informacion mbi **Grupin Tarifor respektiv** ku bën pjesë objekti, për të cilin kërkohet shërbimi i mbikëqyrjes dhe jo mbi disa grupe tarifore, pasi vetëm në këtë mënyrë operatorët ekonomikë mund të përgatisin ofertën e tyre, konform parashikimeve të VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

